

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 10-2014

Trashëgimia dhe format e trashëgimisë sipas Ligjit në Republikën e Kosovës

Lëndita Osmanaj

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

Recommended Citation

Osmanaj, Lëndita, "Trashëgimia dhe format e trashëgimisë sipas Ligjit në Republikën e Kosovës" (2014). *Theses and Dissertations*. 402.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/402>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Fakulteti Juridik

TEMA: Trashëgimia dhe format e trashëgimisë sipas

Ligjit në Republikën e Kosovës

Niveli Bachelor

Lëndita Osmanaj

Tetor, 2014

Prishtinë-



Fakulteti Juridik

Punim Diplome

Viti akademik 2010 – 2011

Studenti : Lëndita Osmanaj

TEMA: Trashëgimia dhe format e trashëgimisë sipas

Ligjit në Republikën e Kosovës

Mentori: Prof.Ass. PHD Berat Aqifi

Tetor, 2014

Prishtinë

*Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme
për Shkallën Bachelor*

ABSTRAKTI

Qëllimi i institutit të trashëgimisë përcaktohet nga rëndësia që ka vetë e drejta e pronësisë në shoqërinë e sotme. Trashëgimia duke qenë një nga mënyrat kryesore të fitimit të pronësisë, tregon për rëndësinë e madhe që ajo ka në qarkullimin civil të pasurisë, midis personave të një shoqërie.

Kjo rezulton edhe nga fakti se ky institut i së drejtës civile jo vetëm është parashikuar si i tillë në Kodin Civil, por ai është rregulluar në mënyrë të hollësishme në mbi njëqind dispozita cka tregon rëndësinë e madhe që i ka kushtuar ligjvënësi këtij instituti të së drejtës.

ABSTRACT

The purpose of the Institution of Heritage is of significant importance in determining of the right of ownership in contemporary society. The Legacy being one of the main ways of gaining ownership shows how great importance it has in civil turnover of assets among people in the society.

In consequence of the above mentioned facts, this institution of the Civil rights is not only foreseen us such in the system but also is regulated in detail way in more than one hundred provisions. This shows us the great importance of this Institution.

Falenderime dhe Mirënjohje

Një punim diplome është një punim akademik që ka një strukturë dhe një qëllim të caktuar, përmes të cilit studenti përfundon studimet në një nivel të caktuar, në rastin tim studimet bachelor në fakultetin e Drejtësisë.

Për ta realizuar një punim diplome duhet kohë dhe mund. Fillimisht dëshiroj të shpreh falenderimet dhe mirënjohjen për të nderuarin Prof. Dr.Berat Aqifin. që pata nderin dhe kënaqësinë ta kem mentor të temës i cili më ndihmën dhe njohurit e tij profesionalë më orientojë në mënyrën më të mirë të realizimit të kësaj teme.

Faleminderit profesor!

Një falenderim të veçantë dhe mirënjohje të thellë i dedikohet familjës sime për mbështetjen që më kanë dhënë në çdo qast ,të cilës i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin më sukses të studimeve të mia.

Gjithashtu falenderoj fakultetin UBT, për mundësin e ofruar dhe për të gjithë profesorët me të cilët kam patur kënaqësinë të ndajmë së bashku orët e ligjeratave gjatë kohës së zhvillimit të studimeve.

Faleminderit të gjithëve!

Prishinë ,Tetor 2014

Permbajtja

ABSTRACT	3
Lënda e Hulumtimit	7
Rëndësia aktuale e temës	7
Metodologjia e Hulumtimit	8
Hyrje	9
a. <u>Vështrim historik mbi institutin e trashëgimisë</u>	10
b. <u>Kuptimi dhe rëndësia e trashëgimisë</u>	11
c. <u>Karakteristikat e së drejtë së trashëgimisë</u>	12
d. <u>Parimet e rregullimit juridik të trashëgimisë</u>	12
e. <u>Koha dhe vendi qeljës së trashëgimisë (Dellatio)</u>	14
f. <u>Zotësia për të trashëguar</u>	15
g. <u>Padenjësia</u>	16
h. <u>Heqja dorë nga trashëgimia</u>	17
KAPITULLI II	18
a. <u>Trashëgimia me ligj</u>	18
b. <u>Rradhët e trashëgimisë</u>	18
c. <u>Shteti si trashëgimtar ligjor</u>	21
d. <u>Trashëgimia me zavendësim (E drejta e përfaqësimit)</u>	21
e. <u>E drejta e shtimit (Jus arescedi)</u>	22
Kapitulli III	22
a. <u>Trashëgimia me testament</u>	22
b. <u>Kuptimi dhe veqoritë e testamentit</u>	23
c. <u>Zotësia për të përpiluar testament</u>	24
d. <u>Përmbajtja e testamentit</u>	24
e. <u>Forma e testamentit</u>	25
f. <u>Testamenti i shkruar nga vetë testatori</u>	25
g. <u>Testamenti me shkrim në praninë e dëshmitarëve</u>	26
h. <u>Testamenti gjyqësor</u>	26
f. <u>Testamenti në rrethana të jashtëzakonshme</u>	30
Kapitulli IV	31
a. <u>Revokimi i testamentit</u>	31

b. Pavlefshmëria e testamentit.....	32
c. Paditë në lidhje me trashëgiminë	32
Literatura	34
Aktet Ligjore	35

Lënda e Hulumtimit

Lëndë hulumtimi i këtij punimi është trajtimin juridik i institutit të trashëgimisë sipas dispozitave ligjore në Kosovë, të cilat do të tregojnë më së miri se në rastin e trashëgimisë si ligjorë, ashtu edhe testamentarë, pasuria e trashëgimëlënësit në kohën e vdekjes nuk mund të kalojnë në favor të cdo personi, por vetëm në favor të personave strikt të përcaktuar nga vullneti i testatorit ose nga ligji.

Trashëgimia si mënyrë e fitimit të pronësisë, në mënyrë që të realizojë funksionimin e saj, kalimin e pasurisë nga trashëgimëlënësi tek trashëgimtarët, duhet që të respektojë të gjitha rregullat ligjor për kalimin e kësaj pasurie.

Rëndësia aktuale e temës

Duke parë rëndësinë që paraqet instituti i trashëgimisë në ditët tona, në kushtet e ekonomisë së tregut dhe të qarkullimit të lirë të mallrave dhe kapitaleve, më ka tërhequr që të bëjë një studim në fushën e të drejtës trashëgimore. Në qoftëse me vdekjen e personave fizikë do të merrnin fund të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij, do të shkaktoheshin një sërë pasojash negativ për shoqërinë dhe individët. Në rradhë të parë marrëdhënjet juridike do të bëhën të pasigurta, ku do të shfaqej rreziku se papritmas do të rrënohej cdo gjë për shkak të vdekjes së ndonjë subjekti.

Kjo pasiguri do të vështëronte e ngadalësonte qarkullimin e mallrave, marrëdhënjet juridike midis personave fizikë, po ashtu do të pushonte edhe e drejta e pronësisë mbi sendet që i takonin personit të vdekur, duke u shëndërruar në sende pa zot. Si të tilla do të ishin të lira për tu fituar me pushtim, mirëpo pushtimi do të bëhëj burim konfliktesh midis atyre që do të dëshironin t'i okuponin.

Metodologjia e Hulumtimit

Gjatë punës kërkimore mbi objektin e studimit, temës së cilës i jam qasur, lind nevoja e përdorimit të disa metodave më qëllim të arritjes së rezultateve të pritura dhe të dobishme për trajtimin dhe sqarimin e objektit të studimit.

Kjo bëhet me qëllim që vëmendja shkencore të mos jetë e mangët duke u bazuar vetëm në një drejtim, por ky studim të jetë më gjithëpërfshirës dhe më cilësor.

Gjatë shtjellimit të temës të dhënat e grumbulluara nga burime të ndryshme janë analizuar, përpunohen duke përdorur metodat adekuatë, në mënyrë që rezultati të jetë i kënaqshëm.

- metoda normative, më anë të kësaj metode jam munduar që ti interpretoj normat në atë mënyrë që të nxjerr në pah atë çka e thotë norma për rastin konkret. Interpretimi duhet të jetë i saktë në mënyrë që të mos lën hapësirë për dyshime.

- metoda historike, përmes kësaj metode do të realizoj përshkrimin e fakteve dhe rrethanave mbi të cilat do të ndërtohet analiza e hulumtimit shkencor gjatë historisë, dhe duke nxjerrë atë që është ende aktuale edhe me kalimin e kohës,

- metoda e analizës, duke analizuar faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me objektin e hulumtimit shkencor më anë të kësaj metode do të nxjerrim rezultate të rëndësishme mbi atë se cila mënyrë është më efikase dhe më frytdhënëse për arritjen e rezultateve të pranueshme.

- metoda krahasuese, kjo metodë ndihmon që të arrihet te një rezultat, duke krahasuar mënyrën e qasjes së vendeve të ndryshme ndaj objektit tim të hulumtimit,

Në fund, paraqiten përfundimet lidhur me objektin e temës së trajtuar në këtë punim.

Hyrje

E drejta civile dhe institutet e saj në përgjithësi më kanë tërhequr cdo herë. Ky interes ka filluar kohë më herët se ti filloi studimet e mia në Fakultetin e Drejtësisë. Për këtë arsye, që në fillim kam menduar se tema që do ta trajtoj për të finalizuar studimet e katër viteve bachelor do të ishte e fokusuar në të drejtën civile.

Ideja për ta trajtuar temën e trashëgimisë ligjore më nxiti nga interesimi im të studioj traditat tona sipas brezave dhe kohërave. Trashëgimia ligjore dhe testamentare sipas ligjeve të R. së Kosovës ka qenë si pikënisje bazore, por gjithashtu krahasuese me ato të Kodit Civil të Shqipërisë. Në mënyrë që të kuptohet më mirë ky institut është e nevojshme që të shikohet zhvillimi i tij në aspektin historik që nga e Drejta Romake, e cila është edhe pikënisje e bazës të studimit dhe njohjen e së drejtës civile e cila ka evoluar nga ajo kohë e gjërë më sot.

Gjatë këtij punimi jam munduar të paraqes një njohje dhe studim modest rreth institutit të trashëgimisë, duke ju referuar literaturës dhe mendimeve të autorëve. Ky punim është ndarë me kapituj.

Kapitulli i parë trajton një përmbledhje historike të institutit të trashëgimisë, kuptimin e nocionit të trashëgimisë, përmbajtja dhe karakteristikat e saj, parimet e rregullimit juridik të trashëgimisë, qelja e trashëgimisë etj.

Kapitulli i dytë i këtij punimi trajton trashëgiminë ligjore, rrethin e trashëgimtarëve ligjor, të drejtën e përfaqësimit, të drejtën e shtimit.

Kapitulli i tretë ka të bëjë me kuptimin e testamentit, përmbajtjen e testamentit, format e testamentit, pavlefshmërinë dhe paditë lidhje me trashëgiminë. Në fund të punimit pasojnë përfundimi dhe literatura e shfrytëzuar për nevojat e këtij punimi.

Ishte kënaqësi të mire më këtë temë sa interesante aq edhe shumë përfshirëse. Mundohesha të citoj dhe skjaroj ligjet egzistuese më qëllim të specifikoj detalet dhe pikat më të rëndësi të institucionit të trashëgimisë.

KAPITULLI I

a. Vështrim historik mbi institutin e trashëgimisë

Shikuar nga aspekti historik institucioni i trashëgimisë konsiderohet si një ndër institucionët më të vjetra të së drejtës civile e cila paraqitet si një fakt social në cdo shoqëri e cila më kalimin e kohës kjo e drejtë ka evoluar nga një stad në tjetër duke vënë në pah të drejtat e barabarta të trashëgimtarëve ligjor. Pasuria trashëgimore e trashëgimëlënësit brëz pas brëzi ka kaluar tek trashëgimtarët sipas brezave juridikisht valide për thirrje në trashëgimi.

Sa i përket legjislacionit konkret që rregullon marrëdhënjet trashëgimore në Kosovë egziston Ligji për Trashëgiminë në Kosovë (LTK) nr. 2004/26. Institucionet e Republikës së Kosovës , kanë bërë një punë të mirë drejt përafrimit të legjislacionit vendor më at të Unionit Evropian , por me pretendim që sa më shpejt të bëhet edhe harmonizimi i këtij legjislacioni me atë të UE së.

Për të gjitha këto do të japim shpjegime bazuar në dispozitat përkatëse të LTK-së. Duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtës së trashëgimisë, rregullimi i tyre në pajtim me legjislacionin bashkëkohor është i domosdoshëm.

Trashëgimia është një institucion mjaft kompleks ,ngërthen në vete një varg çështjesh për të cilat mund të nxirren diskutime pa fund . Është e kuptueshme që në një temë të përfshihen të gjitha të drejtat në lidhje me trashëgiminë, por në pika të shkurtëra do mundohemi ta bëjmë një shpjegim sa më të kurtë të tyre.

Në të drejtën e Romës së lashtë, pasuria e personit që kishte vdekur trashëgohej në kuadër të gjensit, kurse mjetët personale dhe veglat varoseshin bashkë me të vdekurin.¹

Te iliro-shqiptarët familja patriarkale ka egzistuar me shekuj, në epokën e bronzit kur është zhvilluar familja monogame, kur vdiste një anëtarë i familjës nuk hapej çështja e trashëgimisë sepse si trashëgimëlënësi edhe trashëgimtari ishin brenda të së njëjtës familje.

Sipas periudhave kohore hasim në kanunet si ai i Skëndërbëut, Kanuni i Lumës si dhe ai i Lekë Dukagjinit,të cilat përbënin bazat ligjore të detyrueshme për zbatim nga popullësia.

Në Kosovë një kohë të gjatë është zbatuar e drejta e Perandorisë Otomane nën sundimin e së cilës perandori ishim, vlen të përmendim Kodin Civil Turk me emrin Menxhele,i nxjerë pjesë

¹ E Drejta romake, ligjërata të autorizuara,Prof.Dr.Berat Aqifi

–pjesë nga 1869 deri 1876.² Pas vitit 1876 nxirët Kodi Civil I Mbretërisë Serbe, i cili një kohë të gjatë është imponuar për rregullimin e marrëdhënjëve juridiko-civile në Kosovë.

E drejta civile në Kosovë prej pas Luftës së Dytë Botërore e deri në përfundimin e Luftës Clirimtare të Kosovës 1999 është zhvilluar vazhdimisht duke nxjerë ligje të ndryshme në faza të ndryshme historike,ndër këto ligje ishte edhe Ligji për Trashëgiminë .

Pas vitit 1999 fillon një fazë e re e zhvillimit në të drejtën civile duke miratuar ligje të plota duke u mbështetur në legjislacionet e vendeve të zhvilluara evropiane. Më 28 Korrik 2004 Kuvendi i Kosovës miraton ligjin mbi trashëgiminë, i cili ligj është në fuqi dhe sot.

b. Kuptimi dhe rëndësia e trashëgimisë

Trashëgimia është një nga institutet më të rëndësishme të së drejtës civile.Trashëgimia është kalimi i pasurisë pas vdekjes ,nga një person ose disa persona të tjerë sipas rregullave të caktuara me ligj.Në këtë përkufizim janë rregulluar elementet më qënësore të marrëdhënjës së trashëgimisë,që lind ndërmjet një rrethi të kufizuar personash duke filluar nga të afërmit e trashëgimlënësit.

Trashëgimia lind vetëm pasi një person i cili është trashëgimëlënsi, vdes dhe të drejtat dhe detyrimet pasurore kalojnë tek trashëgimtarët e tij.

Rëndësia e këtij instituti,përcaktohet në rradhë të parë nga rëndësia që ka vetë e drejta e pronësisë në shoqërinë e sotme. Trashëgimia duke qenë një nga mënyrat kryesore të fitimit të pronësisë , për shkak të vdekjes ose mortis causa dhe kjo e bënë të veçantë nga të gjitha mënyrat e tjera të fitimit të pronësisë të cilat janë midis të gjallëve ose inter vivos.

Midis të drejtës së pronësisë dhe të drejtës së trashëgimisë ka dallime³.Objekt i së drejtës së pronësisë janë sendet, ndërsa objekt i së drejtës së trashëgimisë është pasuria e trashëgimlënësit që ka egzistuar në qastin e vdekjes së tij.

Këtë pasuri nuk e përbëjnë vetëm sendet, por mund ta përbëjnë edhe të drejtat e detyrimit, d.m.th. që rrjedhin nga kontratat dhe marrëdhënjet e tjera jashtë kontraktore të porealizuara si dhe detyrimet e trashëgimlënësit ndaj të tretëve të pa përmbushura nga trashëgimlënësi.Më fjalë të tjera trashëgimtarëve ju kalon aktivi dhe pasivi i pasurisë që trashëgimlënësi ka patur në

² Gams,A.Hyrje në të drejtën civile,Prishtinë,1988 ,faqe 25

³ Dr.Sc.Hamndi Podvorica.E drejta Trashëgimore,Prishtinë,2010 fq 13.

qastin e vdekjes së tij. Tërësia e këtyre të drejtave dhe detyrimeve që i kalon në trashëgim përbën përmbajtjen e së drejtës subjektive të trashëgimisë.

E drejta jonë si bazë për thirrje në trashëgimi e parasheh trashëgiminë ligjore dhe trashëgiminë me testament.

Forma e parë e trashëgimisë, pra sipas dispozitave ligjore zbatohet në ato raste kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament. Prioritet sipas të drejtës tonë ka trashëgimia me testament. Një gjë e tillë është parshikuar edhe në Kodin Civil të Shqipërisë “Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testamënt ose ka bërë një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testament është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm”.⁴

c. Karakteristikat e së drejtës së trashëgimisë

Kur ndodhemi para këtij instituti është e domosdoshmë të vërtetohen dy kushte:

1. Së pari duhet të vërtetohet vdekja e personit dhe së dyti, të vërtetohet se pesoni ka të drejta dhe detyrime pasurore në të kundërtën nuk mund të celët trashëgimia, sepse nuk ka objekt që do të kalojë nga trashëgimlënësi te trashëgimtarët.
2. Më vdekje të personit kuptohet vdekja natyrore ose fizike, por edhe vdekja juridike d.m.th personi është shpallur i vdekur me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në këtë rast sipas ligjit, “vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet me të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë”.⁵

d. Parimet e rregullimit juridik të trashëgimisë

Parimet kryesore në rregullimin e trashëgimisë janë:

1. **Parimi i barazisë së trashëgimtarëve** -sipas LTK në dispozitën e nenit 3.1, është paraparë se të gjithë personat fizikë janë të barabartë në trashëgimi. Fëmijët jashtë martesor barazohen me ata martesor në pikëpamje trashëgimore, poashtu edhe fëmijët e birësuar trajtohen të barabartë në aspektin e trashëgimit. Kjo barazi shpreh karakterin human dhe demokratik të legjislacionit tonë civil, i cili rregullon marrëdhënjet juridike të

⁴ Neni 317, Kodit Civil të Shqipërisë

⁵ Neni 22/1 I Kodit Civil të R. Shqipërisë

trashëgimisë dhe e ka burimin te neni 24 i Kushtetutës së vendit⁶”sipas të cilit të gjithë janë të barabartë para ligjit, dhe askush nuk diskriminohet në bazë të racës, gjinisë gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, ose ndonjë statusi tjetër personal”.Gjithashtu edhe Ligji për Barazi Gjinore.⁷Parimi i barazisë në trashëgimi, respektohet jo vetëm për personat fizik që janë shtetas të R.se Kosovës,por edhe ndaj shtetasve të huaj,me kusht të reciprocitetit, të prezumohet. Ky parim zbatohet në të gjitha legjislacionet e vendeve demokratike.⁸

2. **Parimi i trashëgimisë testamentare** -Pasuria trashëgimore u kalon trashëgimtarëve testamentarë ose ligjorë,të cilët në varësi të llojit të trashëgimisë gëzojnë pjesën e caktuar.Nëse personi ka disponuar pasurinë e tij me testament, pasuria e tij pas vdekjes do të trashëgohet nga ata persona që trashëgimlënësi ka shprehur me vullnetin e tij.
3. **Parimi i kufizimit të bazave juridike të trashëgimisë** -Askush nuk mund të trashëgojë pa bazë juridike të trashëgimisë.Sipas LTK-se njih dy baza në bazë të cilave mund të thirret në trashëgimi në bazë të ligjit dhe në bazë të testamentit.⁹
4. **Parimi i suksecorit universal**- Personi që trashëgon pasurinë e trashëgimlënësit ose një pjesë të saj quhet suksecor universal.Kalimi në mënyrë universal i pasurisë, nënkupton se të trashëgimtarët nuk kalojnë të drejtat pasurore që ka pasur trashëgimtari në kohën e vdekjes, por edhe detyrimet e pasurisë që ka patur trashëgimlënësi në kohën e vdekjes.Kjo përbën edhe objektin e pasurisë trashëgimore.¹⁰
5. **Parimi suksesorit singular** (i veçantë)-Kjo ndodh në rastet kur trashëgimlënësi disponon me testament vetëm disa sende të caktuara në mënyrë konkrete, në favor të një personi ose disa,në këtë rast personi i cili njihet si legatar përfiton vetëm të drejta ,duke fituar pronësinë mbi sendin e nuk përgjigjet për detyrimet e tjera që mund të ketë pasuria trashëgimore.¹¹

⁶ Kushtetuta e R.së Kosovës, neni 24

⁷ Ligji për Barazi Gjinore, neni 11

⁸ Neni 3, pika 4 i LTK-se

⁹ Neni 8 i LTK-se

¹⁰ Prof.Dr.A. Nuni, L.Hasneziri, E Drejta Civile III (Trashëgimia).Tiranë, 2010, fq16

¹¹ Neni 120 i LTK

6. **Parimi ipso jure ose ex lege** i trashëgimise-Sipas këtij parimi është me rëndësi se pasuria për asnjë qast nuk mbetet pa titullarin e vet. Pra trashëgimtarët pas vdekjes së personit fizik fitojnë të drejtën e trashëgimit. Procedura për hapjen e trashëgimisë bëhet sipas detyrës zyrtare d.m.th ex lege nga ana e gjyqates, pasi të pranohet aktin e vdekjes për personin e caktuar,ose shpalljen e vendimit të personit të vdekur.¹²
7. **Parimi i Kaducitetit** kuptohet fakti juridik se trashëgimlënësi pas vdekjes se tij nuk ka trashëgimtarë dhe kjo pasuria e cila nuk ka trashëgimtarë quhet kadukna.¹³

e. Koha dhe vendi qeljes së trashëgimisë (Dellatio)

Një ndër çështjet kryesore në trajtimin e institutit të trashëgimisë, është përcaktimi i kohës së celjës së trashëgimisë. Nga koha e hapjes së trashëgimisë përcaktohet momenti kur fillon marrëdhënja juridike e trashëgimisë, pra kalimi nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët. Ligji ynë ka parashikuar se trashëgimia qelet në kohën kur kur vdes trashëgimlënësi¹⁴. Parashikimi i bërë nga ligji, ka karakter urdhërues, d.m.th. nuk mund të këtë trashëgimi para vdekjes së trashëgimlënësit.

Këtë e parasheh e Kodi Civil, të cilat përcaktojnë se është e pavlefshme çdo marrëveshje e cila disponon të drejta që rrjedhin nga një trashëgimi që nuk është qelur akoma¹⁵.

Me kohën e celjës së trashëgimisë është e lidhur përcaktimi i rrethit të personave të cilët do të jenë trashëgimtarë, si dhe cili do të jetë ligji i zbatueshëm që do rregullojë kalimin e pasurisë tek trashëgimtarët .

Kodi Civil, përcakton se trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është celur, d.m.th. ligji i kohës së vdekjes së trashëgimlënësit¹⁶.

Na kjo arrijmë në përfundim për rregullimin e marrëdhënjes juridike në trashëgimi pavarësisht nga koha kur lind mosmarrëveshja midis trashëgimtarëve, zatohet ligji i kohës së vdekjes së personit.

Një tjetër moment është edhe vendi i celjës së trashëgimisë sipas Kodit civil, e parasheh vendbanimin e tij të fundit ku aty do të hapet trashëgimia. Nesë në rastet kur vendbanimi nuk

¹² Ligji për Procedurën jokontestimore, neni 59

¹³ Prof. Dr. Abdullah Aliu, E Drejta Civile, Prishtinë, 2013. fq. 52

¹⁴ LTK, neni 5.3

¹⁵ Neni 319 i Kodit Civil

¹⁶ Pjesa e fundit e nenit 38 të Kodit Civil

është i mundur të përcaktohet, ose kur nuk dihet trashëgimia qelet aty ku ndodhet pasuria e trashëgimlënësit. Kjo ka rëndësi për arsye se përcaktohet gjykata kompetente që do të marrë masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore, si dhe për përcaktimin e padive që kanë lidhje me trashëgiminë.

f. Zotësia për të trashëguar

Sipas të drejtës së trashëgimisë një person të jetë i zoti për të trashëguar duhet të jetë në radhët e trashëgimisë ligjore ose të jetë trashëgimtar me testament ,si dhe të jetë gjallë në kohën e qeljes së trashëgimisë.

Në lidhje me zotësinë për të trashëguar ligji parshih se edhe personi i cili nuk ka qënë gjallë, por është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe që ka lindur brenda 300 ditëve i gjallë¹⁷. Ky përjashtim është bërë nga nevoja praktike, sepse mund të ndodh që një person të lind pas vdekjes së trashëgimlënësit, jetë zënë në gjallërinë e tij. Do të ishte e pa drejtë të përjashtohej fëmija i trashëgimlënësit, i cili është trashëgimtar i rradhës së parë dhe që lind pas vdekjes së tij. Përcaktimi i këtij afati 300 ditësh është nisur nga kritere biologjike dhe mjekësore, sepse shtatëzania maksimale mund të zgjasë deri në 300 ditë.

Në rastet kur një person juridik është shpallur i vdekur me vendim gjykate dhe si pasojë është qelur trashëgimia, i cili rezulton më pas i gjallë ,sipas Kodit Civil e njeh të drejtën e kthimit të pasurisë për shkak të qeljes së trashëgimisë¹⁸. Në lidhje me këtë çështje është parashikuar se personi mund të kërkoj pasurinë e tij për mes padisë.

Sa i përketë zotësisë për të trashëguar duhet të kuptojmë vetëm personin fizik dhe jo personin juridik e kjo ndodh në rastin e trashëgimisë ligjore , sepse për nga vet natyra personi juridik është jo një krijesë natyrore e cila mund ti nënshtrohet vdekjes fizike, por një krijesë artificiale e krijuar nga e drejta.

Ndërsa tek trashëgimia me testament është shumë më e gjërë jo vetëm personat fizik, por edhe ata juridik privat apo publik¹⁹.

¹⁷ LTK, Neni 7

¹⁸ Neni 23/2 i Kodit Civil të Shqipërisë

¹⁹ Ardian N., Luan H. E drejta civile III (trashëgimia), Tiranë, 2010 fq.24

g. Padenjësia

Padenjësia parashikohet kategori juridike , e cila ka për qëllim të përjashtoj nga trashëgimia ata persona të cilët kanë mbajtur një qëndërim apo sjellje jo të mirë të trashëgimlënësit. Shkaqet e padenjësisë janë parashikuar në nenin 322 të Kodit Civil të Shqipërisë, dhe në nenin 111 të LTK.²⁰

1. Ai që me dashje ka vvarë apo ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshortën, fëmijët dhe prindërit e tij.
2. Ai që ka bërë kallëzim penal ndaj trashëgimlënësit ose dëshmi të rreme për kryerjen e një veprë penale për të cilën parashikohet dënim me heqje lire mbi 10 vjet, kur dëshmia ose kallëzimi penal janë shpallur të rreme në një gjykim penal.
3. Ai që me mashtrim, kanosje, e dhunë ka shtyr trashëgimlënësin që të bëjë të ndryshojë ose shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rremë, ose ka përdorur atë për interesa të tij apo të tjerëve.
4. Ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë.
5. I padenjë për të trashëguar është edhe personi që nuk e ka përmbushur detyrimin për të mbajtur apo për të ndihmuar trashëgimlënësin.

Parashikimi i këtij rasti të padenjësisë është bërë nga ligji nisur nga parimi se askush nuk mund të përfitojë nga keqbërjet e tij. Nga kjo konkludojmë se padenjësia mund të përcaktohet si sanksion civil dhe këtu vlen të përmendim parimin” nulla poena sine lege”.

Ligji e ka njohur të drejtën e trashëgimlënësit, që të falë personin e padenjë për të trashëguar, por falja të jetë e vlefshme duhet të bëhet në një nga këto mënyrat;

1. Falja të behët shprehimisht me akt noterial
2. Falja të përcaktohet në testament
3. Falja të bëhet edhe pse është në dijeni të padenjësisë prap se prap e cakton atë si trashëgimtarë.²¹

²⁰ Ligji i Trashëgimisë së Kosovës, neni 111

²¹ Neni 324 i Kodit Civil

Për disa shkaqe që shkaktojnë padenjësinë e një personi për trashëgimi, gjykata është e detyruar të kujdeset sipas detyrës zyrtare e për disa shkaqe të tjera vetëm kur pala e interesuar ngre kundërshtim.²²

h. Heqja dorë nga trashëgimia

Sipas legjislacionit tonë është njohur edhe mundësia e trashëgimtarëve për të hequr dorë nga trashëgimia. Heqja dorë nga trashëgimia është një akt i njëanëshëm ,do të thotë mjafton shfaqja e vullnetit të vetëm një palë dhe nuk është e nevojshme që të shfaqë vullnetin një palë tjetër .Heqja dorë është një veprim juridik solemn,ku trashëgimtari me deklaratë të dhënë pranë gjykatës derisa të përfundojë seanca e trashëgimisë(neni 130-138 LTK-së)

Në Kodin Civil, heqja dorë gjen rregullim në nenet 333 deri 340 .²³ Heqja dorë duhet të bëhet brenda një afati të caktuar ligjor,i cili është 3 muaj nga qelja e trashëgimisë kur trashëgimtari ndodhet brenda vendit dhe 6 muaj nga i njëjti moment kur trashëgimtari ndodhet jashtë shtetit.

Cdo trashëgimtar madhor që gëzon zotësi të plotë për të vepruar,mund të heq dorë nga trashëgimia vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të tij të pajisur më autorizim të posaqmë.²⁴ Të miturit nga 14-18 vjeq dhe personat me zotësi të kufizuar për të vepruar, heqjen dorë nga trashëgimia do ta bëjnë vetë por me pëlqimin e prindit apo kujdestarit²⁵.

Një tjetër çështje lidhet se shteti ose personat juridikë kanë të drejtë apo jo të heqin dorë nga trashëgimia derisa kjo e drejtë nuk është njohur shprehimisht në ligj.²⁶ Mendojmë se ky argument pse shteti nuk mund të heq dorë nga trashëgimia mund mos të jetë i saktë ,sepse dihet shtetit i kalon trashëgimia vetëm atëherë kur nuk ka trashëgimtarë ligjor ,,kur ata kanë hequr dorë,janë përjashtuar si të padenjë,dhe kur nuk ka lënë trashëgimlënësi testament. Duke pasur parasysh në bazë të nenit 172 Kodit Civil kjo pasuri do ti kalonte shtetit²⁷, si sende pa zot.Një gjë të tillë e parashikon edhe ligji ynë ,neni 21.1 ku thuhet” Nëse trashëgimlënësi nuk ka

²² Dr,Sc Hamndi Podvorica, E drejta trashëgimore,Prishtinë,2010,fq. 81

²³ Neni 333-340,Kodit civil

²⁴ Kodi Civil, nenet 6-10

²⁵ Kodi i Familjës,neni 229

²⁶ Nazmi Bicoku,E Drejta e Trashëgimisë së R.Sqipërisë,Tiranë,1997,fq. 63

²⁷ Kodi Civil,neni 172

lënë trashëgimtarë ligjor dhe testamentar, konsiderohët se trashëgimia i takon komunës, ku trashëgimtari ka pasur vendbanimin e tij të fundit”²⁸

Heqja dorë nga trashëgimia është e pa revokueshme, sepse kjo ka fuqi obliguese ndaj deklaratdhënësit²⁹. Revokueshmëria e deklaratës do të shkaktonte pasiguri juridike në qarkullim, sepse do çenoheshin edhe të drejtat e personave të tjerë mbi të cilët ka kaluar e drejta e trashëgimisë.

KAPITULLI II

a. Trashëgimia me ligj

Trashëgimia me ligj, nga një përjashtim sipas ligjit zbatohet vetëm në ato raste kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament ose testament është tërësisht apo pjesërisht i pavlefshëm. Në bazë të trashëgimisë ligjore qëndron marrëdhënja familijare midis trashëgimlënësit dhe trashëgimtarëve, duke përfshirë të afërmit më të ngushtë deri në shkallë të gjashtë, në mungesë të tyre trashëgimtar bëhet shteti. Në vendin tonë shumicën e rasteve njerëzit vdesin pa bërë testament, atëherë trashëgimia ligjore përbënë llojin kryesor të trashëgimisë.

b. Rradhët e trashëgimisë

Në Kodin Civil përcaktohen në mënyrë të shprehur se cilët janë trashëgimtarët ligjorë të cilët thirren në trashëgimi sipas radhës së përcaktuar në varësi të afërsisë të secilit me trashëgimlënësin. Si fakt më i rëndësishëm për formimin e rradhëve të trashëgimisë ligjore janë marr gjinia dhe martesat.

Trashëgimtarët ligjorë sipas Kodit Civil janë:

1. Fëmijët ose fëmijët e fëmijëve ose të paslindurit e tyre
2. Bashkëshorti pasjëtues

²⁸ LTK, neni 21.1

²⁹ Dr.Sc.Hamndi Podvorica, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë, 2010, fq. 86

3. Prindërit e trashëgimlënësit
4. Vëllzërit dhe motrat ose fëmijët e vëllzërve dhe motrave të paravdekur
5. Gjyshi dhe gjyshja dhe të paralindurit e tyre ku bëhet fjalë për stërgjyshërit
6. Personat e paaftë në ngarkim të trashëgimlënësit
7. Të afërmit e tjerë deri në shkallë të gjashtë
8. Shteti ³⁰

Edhe sipas LTK-së neni 11.1 parasheh trashëgimtarët ligjor të cilët janë fëmijët e trashëgimlënësit, të birësuarit, bashkëshorti, prindërit, vllëzërit, motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi dhe gjyshja si dhe pasardhësit e tyre.

Në radhë të parë në trashëgimi janë fëmijët dhe bashkëshorti duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Duke nisur me fëmijët e trashëgimlënësit, të cilët janë pasardhësit më të afërt ku lidhja e tyre mund të jetë lidhje gjaku ose lidhje mbi baza birësimi. Me lidhje gjaku, fëmijët mund të jenë nga martesë por edhe jashtë martesë. Këtu gjejmë mbrojtje kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e R.së Shqipërisë, neni 54 e sanksionon “fëmijët e lindur jashtë martesës, kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë”³¹. Po ashtu edhe sipas nenit 362 të Kodit Civil “Fëmijët e lindur jashtë martesë, ku atësia është e njohur barazohen me fëmijët legjitim”³². Me fëmijët barazohen edhe të birësuarit, sepse me anë të birësimit krijohet një marrëdhënie e re familjare dhe juridike, si dhe shuhet çdo lidhje me familjen e tij të origjinës.

Kategoria tjetër sipas rradhës që thirrën në trashëgimi është bashkëshorti/ja. Është qartë tashmë veprimi i parimit të barazisë midis burrit dhe gruas.

Historikisht gruaja ka qënë në pozitë diskriminuese në shoqëri, po ashtu edhe në aspektin e së drejtës së trashëgimisë. Gruaja është konsideruar si person i huaj dhe pa të drejtë trashëgimi. Kjo e fundit ndërtohej vetëm me lidhje gjaku. Kanunit të Lekë Dukagjinit thotë “Në rast se trashëgimtari është femër, atëherë duhet të kërkohet mashkulli deri në shokën e 12 vetëm e vetëm kjo pasuri të mos i jepet një femre”³³. Në një pjesë tjetër thuhet: një për trashëgues djalin e jo vajzën.

Në atë kohë përkundër këtij botëkuptimi mjaft të ashpër Kodi Civil i vitit 1929 kishte një qëndrim mjaft të avancuar në nenin 486 i parsheh të drejtat trashëgimore të bashkëshortit pasjetues.³⁴ Më kalimin e kohës konceptime të tilla filluan të ndryshonin, sot bashkëshorti është pjestarë i vërtet i familjës, madje pjestarë i afërt, pavarësisht mungesës së lidhjes së

³⁰ Neni 360 i Kodit Civil

³¹ Kushtetuta e Shqipërisë, neni 54

³² K.Civil, Neni 362

³³ Kanuni i Lekë Dukagjinit, Rilindja, Prishtinë. 1995

³⁴ Kodi Civil i vitit 1929, neni 486

gjakut. Bashkësori pasjetues mer në cdo rast 1/2 e pasurisë që është lënë në trashëgimimi por nuk konsiderohet si trashëgimtar ekskluziv, kjo do të thotë se ai nuk e ka statusin që kanë fëmijët në rast së trashëgimlënësi ka lënë pasarrdhës. Për sa i përketë ndarjes së pasurisë bashkëshorti mbetet në konkurrencë me trashëgimtarët e rradhëve të tjera.

Edhe LTK-së në aspektin juridik është dukshëm i avansuar, rregullon pa diskriminim cështjën e të drejtës së trashëgimisë tek gratë, varësisht se në çfarë pozite sociale paraqitët gruaja, ajo me këtë ligj ka një pozitë të barabartë me burrin dhe si trashëgimtare zë vendin e rradhës së parë. Në nenin 1.4, të këtij ligji emrat në gjininë mashkullorë nënkuptojnë edhe emrat e gjinisë femërore dhe anasjelltas, pa diskriminim.³⁵ Mirëpo vlen të theksojmë se në praktikë nuk ka egzistuar kjo barazi, sidomos në Kosovë me vite kanë funksionuar disa rregulla zakonore dhe morale, e veqanarisht në ato vende të varfëra ose në zonat rurale gratë nuk trashëgojnë pronë kur vdesin baballarët ose burrat.³⁶

Mirëpo kemi raste kur bashkëshortët, nuk mund të trashëgojnë njëri-tjetrin kur martesë e tyre është e pavlefshme apo kur janë të shkurorizuar (neni 27) LTK-së.

Për veq personave të tjerë që thirren në trashëgimi sipas rradhës janë prindërit, vëllëzërit dhe motrat, gjyshi e gjyshja egziston një kategori e veqantë e trashëgimtarëve ligjorë që janë personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, themi të veqantë sepse këta persona nuk përfshihen si trashëgimtarë për shkak të lidhjes së gjinisë më trashëgimlënësin, por për shkak të parimeve të humanizmit.³⁷

Kodi Civil ka përcaktuar kushte specifike, në mënyrë që cdo person të thirrret si trashëgimtarë ligjor.³⁸

1. Të jetë i paaftë për punë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit,
2. Të ketë bashkëjetuar si anëtar në familjën e trashëgimlënësit të paktën për një vit,
3. Të ketë qënë në ngarkim të trashëgimlënësit

Në lidhje më kushtin e parë si person të paaftë për punë, Kodi Civil ka vendosur si kriter në rradhë të parë moshën, që personi në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit të jetë nën 16 ose 18 vjeq kur vazhdon mësimet, si dhe personat (burri) mbi 60 vjeq e gruaja mbi 55 vjeq kjo është nisur nga dalja në pension pleqërie dhe si pasojë janë të paaftë për punë, si dhe në rradhë të dytë gjendjen shëndetësore të personit. (neni 371).

³⁵ LTK, neni 1.4

³⁶ Tawil, Edward "Të Drejtat Pronësore në Kosovë; Një trashëgimi e shoqërisë në tranzicion" shkurt 2009, fq.22

³⁷ A. Nuni, L. Hasneziri, E Drejta Civile III (Trashëgimia), Tiranë, 2010 Fq.61

³⁸ Kodi Civil, neni 363

Kushti i dytë që të ketë jetuar si anëtarë i familjës së trashëgimlënësit, pra si pjesë e familjës e jo si një i huaj që rri në banesë me qira ose huapërdorës, ligji ka vendosur një afat minimumin një vit që personi të ketë bashkëjetuar me trashëgimlënësin,

Kushti i tretë të ketë qënë në ngarkim në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, qështja në ngarkim nënkuptojmë që trashëgimlënësi të ketë patur detyrimin për ushqim ndaj këtij personi. Ky kusht parashihet edhe nga ligji i Kosovës të drejtat e personave ndaj të cilëve trashëgimlënësi ka paguar detyrim për ushqim ose mbajtje nuk shuhen, por ato të drejta kalojnë te trashëguesit të cilët janë përgjegjës për pagimin e këtij borxhi³⁹.

c. Shteti si trashëgimtar ligjor

Trashëgimtarë të fundit që ligji e parashikon, në mungesë të të gjithë trashëgimtarëve ,ose ka trashëgimtarë, por këta janë bërë të padenjë për të trashëguar, kanë hequr dorë, apo janë përjashtuar nga trashëgimia. Në të gjitha rastet kur shteti bëhet trashëgimtar, ai përfiton jo vetëm të drejtat mbi pasurinë trashëgimore , por dhe detyrimet e kësaj pasurie, i cili është i detyruar që të shlyej kundër të tretëve njësojë si të gjithë trashëgimtarët e tjerë.

Sipas LTK-së nesë nuk dihet për trashëgimtar, atëherë gjykata më anë të shpalljes do t'i thrras personat që pretendojnë së kanë të drejtë për trashëgimi që të paraqitën në gjykatë. Shpallja duhëet të publikohet në fletorën zyrtare ose në një tjetër të përshtatshme për t'i informuar trashëgimtarët pretendent që janë të detyruar të paraqiten pranë gjykatës në afatin ëe caktuar. Ky afat është 1 vit nga data e publikimit të shpalljes, në qoftëse afati skadon dhe nuk paraqitet asnjë trashëgimtarë, atëherë gjykata me vendim, pasurinë trashëgimore ia dorëzon komunës kompetente.

d. Trashëgimia me zvendësim (E drejta e përfaqësimit)

Zvendësimi është një institut tjetër shumë i rëndësishëm që zbatohet në rastet kur jemi para kalimit të pasurisë më anë të trashëgimisë. E drejta e zvendësimit është parashikuar sipas ligjit tonë ,sepse mund të ndodh që pjesa takuese e një trashëgimtari të mbetet "vakante" pra pa titullar ,pasi ky i fundit mund të ketë vdekur para trashëgimlënësit ose për ndonjë shkakë tjetër këtë e zvendësojnë pasardhësit e tij ,pra fëmijët ose fëmijët e fëmijëve e kështu me radhë⁴⁰.

³⁹ Ligji për trashëgiminë e Kosovës, nr.2004/26, neni 29

⁴⁰ Po aty , neni 13

e. E drejta e shtimit (Jus arescedi)

E drejta e shtimit është një rregull tjetër që zbatohet në trashëgiminë ligjore,po ashtu edhe në trashëgiminë me testament.Kjo e drejtë gjen zbatim në rastet kur një ose disa trashëgimtar kanë vdekur para trashëgimlënësit ose ,janë përjashtuar nga trashëgimia,apo kanë hequr dorë,janë shpallur të padenjë.Kur flasim për të drejtën e shtimit duhet pasur parasysh së kjo e drejtë zbatohet vetëm në rastet kur nuk është e mundur të zbatohet trashëgimia me zavendësim.⁴¹

Kapitulli III

a. Trashëgimia me testament

Testamenti ishte i njohur që nga e drejta romake e cila ishte shprehje e dëshirës së trashëgimlënësit se kujt do ti takoj dhe si do të ndahet pasuria në rast vdekje, kryefamilijari kishte të drejtë që nëpërmjet testamentit,me pasurinë e tij të vepronte si të donte,ti linte testament njeriut të huaj dhe të ju ndalonte të drejtën e trashëgimisë fëmijëve të tij.

⁴¹ Neni 370,Kodi Civil

Testamenti është një veprim i njëanëshëm që realizohet në prani të dëshmitarëve dhe ishte forma më e zakonshme e fitimit të pasurisë mortis causa.⁴²

Sipas drejtës romake testamenti paraqiste këto karakteristika të njëjtat i shohim edhe në të drejtën bashkëkohor:

1. Jus civile
2. Plotësisht personal
3. Akt formal
4. Veprim i njëanëshëm
5. I revokueshëm

b. Kuptimi dhe veqoritë e testamentit

Kuptimi i testamentit jepet në nenin 69.1 të LTK-së i cili parashikon:” Testamenti do të thotë shprehje e vullnetit të fundit e dhënë në formën e paraparë me ligj, me anë të cilit trashëgimlënësi(testatori) urdhëron se si të vepohet me pasurinë e tij pas vdekjes së tij”.Nga kuptimi që i jep ligji testamentit,mund t’i nxjerrim disa veqori e këto janë:

1. Testamenti është veprim juridik i cili krijon të drejta dhe detyrime për trashëgimtarët testamentar, pra duke krijuar një marrëdhënie juridike të vullnetshme sepse vetë hartimi i testamentit varet nga vullneti i trashëgimlënësit.
2. Testamenti është një veprim juridik”intuitu personae”d.m.th.një veprim ngushtësisht personal i cili mund të kryhet nga vetë testatori dhe nga asnjë person tjetër, përjashtohet cdo mundësi përfaqësimi për të bërë testament.
3. Testamenti është një veprim i revokueshëm ,ku testatori mund ta revokojë testamentin e bërë në cdo kohë më anë të një deklaratë me shkrim para noterit ose më anë të ndonjë testament të ri ku e rrëzon testamentin e mëparëshëm.

⁴² E Drejta Romake,ligjerata të autorizuara,Prof.Dr. Berat Aqifi

4. Testamenti është një veprim juridik i llojit të veçantë (sui generis), sepse sjell pasojat juridike, jo në kohën e hartimit të tij, por në kohën e vdekjes së tij “mortis causa”.
5. Testamenti është veprim juridik më anë të cilit bëhet kalimi e pasurisë trashëgimore nga testatori tek trashëgimlënësi.
6. Testamenti është veprim juridik formal solemn (ad substantiam) që do të thotë për të qënë e vlefshme duhet të bëhet në formën e caktuar me ligj, në të kundërtën është i pavlefshëm⁴³.

c. Zotësia për të përpiluar testament

Nga vetë rëndësia që ka testamenti ,zotesia për të përpiluar testament është rregulluar në mënyrë të shprehur nga ligji ku thuhet për të bërë testament personi duhet të ketë zotësi të plotë për të vepruar.Në bazë të nenin 70 testament mund të bëjnë cdo person që ka zotësi për të vepruar dhe ka mbushur 18 vjet⁴⁴.Ligji po ashtu përcakton se personave të cileve me vendim gjyqi është hequr zotësia për të vepruar,si dhe gjatë kohës së bërjes testament nuk është në gjendje për ta kuptuar rëndësinë e veprimit të tij,nuk mund të bëjë testament(neni 70.4)LTK-së.

d. Përmbajtja e testamentit

Vullneti i testatorit i shprehur në veprim juridik të testamentit ,përbën përmbajtjen e tij. Përmbajtja e testamentit është element i domosdoshëm i cdo testament. Elementet e domosdoshëm për përmbajtjen e testamentit janë:

1. Caktimi i trashëgimtarëve në testament
2. Caktimi i pasurisë që do të lihet në testament
3. Caktimi i pjesëve të pasurisë që do t’i fitojë me testament trashëgimtari/ët

⁴³ Neni 404 i Kodit Civil

⁴⁴ Neni 70.1 i LTK-së

Tre elementet janë të detyrueshëm që testatori t'i përcaktoj, përndryshe mungesa e njërit prej tyre humbet vlerën duke mos qenë fare para testamentit, pra testamenti konsiderohet sikur nuk është bërë fare.

Sa i përketë elementit të parë caktimin e trashëgimtarëve Kodi civil jep të drejtën testatorit që ta disponojë pasurinë e tij në favor të një ose disa personave ,por këtë të drejtë nuk e njuh pa kufi,që do të thotë testatori duhet të respektojë kufizimet e caktuara ligjorë në caktimin e trashëgimtarëve testamentarë.Rrethi i personave që mund të përfitojnë me testament përcaktohet nga neni 374-377 të K. Civil .Testatori nuk mund të caktojë si trashëgimtarë me testament një person ose subjekt jashtë rrethëve të trashëgimtarëve ligjorë të parashikuar në nenin 360 K.Civil,sepse në të kundërtën ky disponim në favor të këtij personi është i pavlefshëm.⁴⁵

Elementi i dytë i përmbajtjes së testamentit është caktimi i pasurisë nga ana e testatorit që do ti kalojë trashëgimtarëve gjithë pasurinë ose një pjesë të kësaj pasurie gjithmonë sipas vullnetit të testatorit.

Elementi i tretë caktimi i pjesëve të pasurisë që u takon trashëgimtarëve,testatori duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë pjesën konkrete të secilit trashëgimtarë.

e. Forma e testamentit

Testamenti detyrimisht duhet të bëhet në formën e caktuar ligjrisht pasi forma është e nevojshme për thelbin e veprimit juridik në të kundërtën mos respektimi i formës sjell pavlefshmërinë e testamentit.Llojet e testeenteve në LTK-se janë të rregulluara më nenet 74,75,76 dhe 77 e ato janë:

1. Testamenti i shkruar nga vetë testatori
2. Testamenti me shkrim në praninë e dëshmitarëve
3. Testamenti gjyqësor
4. Testamenti në rrethana të jashtëzakonshme

f. Testamenti i shkruar nga vetë testatori

⁴⁵ A. Nuni,L.Hasneziri,E Drejta civile III(trashëgimia),Tlranë,2010 fq.100

Testamenti është i vlefshëm në qoftëse testatori e ka shkruar atë , datuar dhe nënshkruar me dorën e tij ose ka vënë gishtin e vet. Data e testamentit duhet të tregoj ditën, muajin dhe vitin.⁴⁶ Nënshkrimi duhet të përmbajë mbiemrin si dhe emrin në fund të testamentit. Një gjë të tillë është paraparë në nenin 393/1 të Kodit Civil. Shkrimi tërësisht me dorën e testatorit , nënkupton që në testament të jetë dorëshkrimi i tij dhe jo i shkruar me mjete mekanike.

g. Testamenti me shkrim në praninë e dëshmitarëve

Testatori që di të shkruaj dhe të lexoj mund ta përpilojë testamentin duke nënshkruar me dorë , pa marrë parasysh kush e ka përpiluar, në praninë e dy dëshmitarëve që e kuptojnë gjuhën e testamentit, duke deklaruar se testament është i tij.⁴⁷ Këtu nuk ka rëndësi se kush dhe si e shkroi testamentin, esenciale është forma ta nënshkruaj trashëgimlënësi në prani të dy dëshmitarëve . Kjo vërtetohet me nënshkrimet e tyre në vetë testamentin.

d. Testamenti gjyqësor

Ky lloj testament përpilohet nga gjyqëtari gjithmonë sipas vullnetit të trashëgimlënësit dhe në kushtet eë parapara me ligj. Gjyqëtari pas përpilimit i jep testatorit testamentin ta lexojë dhe ta nënshkruaj , pas kësaj gjyqëtari e shënon vet në testament se testatori e ka lexuar dhe nënshkruar atë në praninë e tij. Kjo vlen në rastet kur testatori është në gjendje ta lexojë, ndërsa në rastet kur testatori nuk është në gjendje ta lexojë testamentin që ia ka përpiluar gjyqëtari , ky i fundit ia lexon në praninë e dy dëshmitarëve. Testatori pas kësaj e nënshkruan ose e vë në të shenjën e gishtit të vet, po ashtu edhe dëshmitarët duhet ta nënshkruajnë testamentin.

Një formë tjetër e hartimit të testamentit është testament me akt noterial. Kjo formë e testamentit është më i këshillueshëm nga pikëpamja juridike sepse jep më shumë siguri si për përmbajtjen ashtu dhe për shprehjen e vullnetit të testatorit.

⁴⁶ Neni 74 , LTK-së

⁴⁷ Neni 75.1 , LTK

Gjithashtu noteri e nje testatorin me dispozitat ligjore dhe nënshkruhet nga testatori në prani të noterit. Në ligjin për noterinë janë përcaktuar elementet që duhet të përmbajë një akt noterial e për pasojë edhe testamenti është akt noterial.

Ju prezentoj një formë të shembullit të shkruarjes së testamentit:

Dëshira e fundit dhe Testamenti

Emri Mbiemri _____

Nr. Personal _____

Adresa _____

1. Deklaratë

Unë _____, deklaroj se kjo dëshira ime dhe testamenti.

Unë _____, deklaroj se jam në moshën ligjore për të shprehur vullnetin tim dhe jam plotësisht i vëdiqshëm se kjo dëshirë e fundit dhe testamenti i shprehur është pa ndikim, mashtrim apo detyrim.

2. Detajet e familjës

Unë jam i martuar me _____, dhe më tutje do të referohemi si bashkëshortë.

Unë kam fëmijët si më poshtë:

Emri: _____, Data e lindjës _____,

Emri: _____, Data ëelindjës _____,

3. Emërimi i ekzekutorit

3.1. Me këtë emëroj, _____, si ekzekutuës për të ekzekutuar këtë testament.

3.2. Me këtë i japim të gjitha autorizimet ekzekutorit dhe autoritetin që kërkohet ose lejohet sipas ligjit.

3.3. Me këtë shpreh që ekzekutuesi i testamentit nuk do të kërkohet që të jap dokument sigurie dhe se ai do bëjë ëekzëekutimin pa asnjë kufizim.

4. Përfituesi

Unë _____, i lë trashëgim gjithë pronën, pasuritë e mia të luajtshme apo të paluajtshme, ku do që ndodhen dhe të çfarëdo natyre, djalit _____.

5. Përfituesit Alternativë

Në rast se nesë djali im nuk do të mbijetojë trashëgimin Unë _____, i lë trashëgim gjithë pronën, pasuritë time të luajtshme apo të paluajtshme, ku do që ndodhen dhe të çfarëdo natyrë, nipërve dhe mbesave _____, dhe që duhet të ndahet në mes tyre në pjesë të barabarta.

6. *Përfashtimi nga Trashëgimi*

Unë _____, deklaroj se _____, është përfashtuar nga trashëgimi i pronave, pasuritë tona të luajtshme apo ë paluajtshme, ku do që ndodhen dhe të çfarëdo natyrë, të ditura dhe jo të ditura.

7. *Kërkesat speciale*

Me rastin e vdekjes sime, të gjitha shpenzimet e varrimit do të paguhen nga pasuria ime.

8. *Të përgjithshëm*

Nesë ndonjë dispozitë e këtij testamenti interpretohet nga ndonjë gjykatë kompetentë , ajo nuk do të ketë efekt të asnjë nga dispozita e mbetura.

Unë _____, si dëshmi e këtij testamenti unë do ta nënshkruaj me dorën time me datë _____, në ora ____ në shtëpi time, Rruga _____, Prishtinë në prani të dëshmitarëve të nënshkruar.

Emri i Trashgëmlënsit _____

Nënshkrimi: _____

Dëshmitarët

Si dëshmitarë ne deklarojmë se jemi plotësisht të vëdijshtëm dhe të moshës ligjore për të dëshmuar dëshirën e fundit dhe testamentin të _____, dhe sipas gjitha njohurive tona _____, është i moshës ligjore për të bërë një testament, duket qenë të vëdijshtëm ka nënshkruar këtë më dëshirë e vet dhe pa ndikim mashtrim apo detyrim.

Ne deklarojmë se _____, ka nënshkruar këtë në praninë tonë si dëshmitarë nënshkruar.

Nën kërcënimin e ligjit për dëshmi të rreme, ne deklarojmë këto deklarata të jenë të vërteta dhe të sakta në këtë ditë me datë _____, në ora ____ Prishtinë.

Dëshmitari-1

Emri _____

Adresa: _____

Nënshkrimi: _____

Dëshmitarit-2

Emri _____

Adresa: _____

Nënshkrimi: _____

f. Testamenti në rrethana të jashtëzakonshme

1. Testamenti me gojë

Për veq këtyre formave të mësipërme të testamentevë,ligji ynë njih edhe disa forma të tjera në disa rrethana të caktuara në të cilat ndodhet testatori , të cilat njihen nga ligji me emrin testament në rrethana të jashtëzakonshme p.sh zjarri, tërmeti,lufta,aksidentet e rënda në komunikacion etj. Testatori mund ta deklarojë vullnetin e tij me gojë para dy dëshmitarëve,vetëm në raste të jashtëzakonshme nuk është në gjendje të bëjë testament me shkrim (neni 81,LTK).Testamenti me gojë bëhet i pavlefshëm nese nuk deklarohet në gjykatë nga dëshmitarët 30 ditë pas pushimit të rrethanave të jashtëzakonshme .

Kodi Civil njih edhe disa forma të tjera që njihen si teste të posaqme, i referohet rasteve kur personi ndodhet në shëbrim ushtarak.Në këto raste testamenti mund të vërtetohet nga komandati i njësisë ushtarake ku bën pjesë ai.⁴⁸ Testament tjetër i parashikuar nga K.Civil është kur personi ndodhet në anije shqiptare që ndodhet në lundrim ose ka qëndruar në një port të huaj, këtë rast testamenti mund të vërtetohet nga kapiteni i anijës.⁴⁹Testamenti ushtarak dhe testamenti në anije nuk janë të rregulluara me dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë e Kosovës.

2. Legu dhe Barra

Legu dhe barra janë dy çështje të rëndësishme të trashëgimisë me testament,të cilat në thelb janë të ndryshme .Element të përbashkët që kanë të dy institutet është se trashëgimtarët ligjor janë të detyruar të kryejnë një ose disa detyrime të caktuara në favor të personve të tjerë. Instituti i legut është rregulluar që nga e drejta romake,ku legu konsiderohej si dhuratë e trashëgimlënsit në favor të legatarit.Sipas të drejtës romake format e lënies së legut ishin testamentet dhe kodicilet dhe objekt i legut mund të ishin të gjitha sendet që ishin objekt i trashëgimit,madje edhe sendet që nuk përbënin pjesë të pasurisë trashëgimore.⁵⁰ Si shumë legjislacione të vendeve perndimore edhe legjislacioni ynë ka bërë rregullimin e tij duke u referuar traditës romake.Nga formulimi që i ka bërë legut ,rezulton se legu është një detyrim apo urdhërim i trashëgimlënsit në testament të këtë caktuar shprehimisht që një ose disa trashëgimtarë testamentar t'u dorëzojnë një ose disa personave një përfitim pasuror nga trashëgimi.Kjo mënyrë e të trashëguarit quhet leg,ndërsa personit që është destinuar legu

⁴⁸ Pjesa e parë e nenit 399 të K.Civil të Shqipërisë

⁴⁹ Po aty ,neni 400

⁵⁰ E Drejta Romake,Ligjerata te autorizuara ,Pr.Dr.Berat Aqifi

quhet legatar.⁵¹ Nëse trashëgimlënësi nuk ka lënë testament si dhe nuk ka përcaktuar shprehimisht, atëherë nuk jemi përpara institutit të legut. E drejta e legut është një e drejtë personale d.m.th. i takon vetëm personit të cilit i është caktuar nga testatori në testament.

Ekzekutimi i legut bëhet nga ekzekutori i testamentit ose në mungesë të tij nga ana e trashëgimlënësit i cili është ngarkuar me legun. Në rastet kur trashëgimtari i ngarkuar me legun nuk e shlyen legun vullnetarisht, legatari sipas Kodit Civil ka të drejtë që ta realizojë të drejtën e tij të legut duke u drejtuar gjykatës me padi, e cila është një padi detyrimi dhe e ngarkon trashëgimtarin që ta shlyej legun sipas urdhërimeve të trashëgimlënësit.⁵² Kjo e drejtë është parshikuar edhe në LTK, neni 94.1.

Cështje tjetër e rëndësishme në lidhje me trashëgiminë me testament është edhe barra, e cila ka detyrimin e trashëgimtarit që të kryej ndonjë veprim të dobishëm për shoqërinë, këtu përfshinë edhe shtetin. Ligji përcakton se kur trashëgimlënësi e disponon pasurinë në favor të shtetit ose organeve të tjera publike, ai ka të drejtë të përcaktojë qëllimin për të cilin do përdoret kjo pasuri⁵³, qëllimi duhet të jetë gjithmonë i ligjshëm, me zakonet e mira, normat e moralit apo me parimet e përgjithshme të drejtësisë.

Duke trajtuar këto dy institute të legut dhe barrës arrijmë të kuptojmë së shkak i legut është qëllimi i testatorit që të përfitojë nga pasuria e tij edhe trashëgimtarë të tjerë ligjor që nuk mund të thirrën në trashëgimi për shkak të rradhës ose dhe për persona të tjerë jo trashëgimtarë, ndërsa te barra qëllimi i testatorit që pasuria e tij të përdoret jo në favor të një ose disa personave të caktuar, por të përdoret në dobi të shoqërisë.

Kapitulli IV

a. Revokimi i testamentit

Me Revokim kuptojmë lënjen pa fuqi të testamentit me datë të më përparshme nga një testament që daton më vonë, në tërësi ose vetëm një pjesë që nuk pajtohet me testamentin e ri⁵⁴. Testatori mund ta revokoj ose ta ndryshoj testamentin deri në momentin e fundit të jetës së tij.

⁵¹ Neni 93.1, LTK-së

⁵² Neni 391/1 i Kodit Civil

⁵³ Neni 88.3, LTK-së

⁵⁴ Neni 402 i Kodit Civil

Revokimin e testamentit testatori mund ta bëjë më anë të një testamenti të ri ose më anë të një deklarate para noterit. Neni 107 dhe 108 i LTK-së përcakton revokimin dhe mënyrat e zbatimit të saj.

b. Pavlefshmëria e testamentit

Testamenti si shfaqje e ligjshme e vullnetit të personit për të caktuar fatin e pasurisë së tij pas vdekjes mund të ndodhë që të bie ndesh me normat urdhëruese të ligjit dhe në këto kushte të jetë i pavlefshëm. Rastet kur testamenti është i pavlefshëm janë parashikuar në Kodin Civil nga neni 403 deri 410 të tij dhe jo për shkaqe të tjera të cilat mund t'i qmojnë palët ose gjykata. Kjo ka ndodhur për të shmangur çdo lloj abuzimi të gjykatës në shpalljen e testamentit të pavlefshëm.

Pavlefshmëria e testamentit mund të jetë absolute dhe relative.

Shkaqet që sjellin pavlefshmërinë absolute janë të përcaktuara me ligj, si testament i bërë nga një person që nuk mund të bëjë testament nuk ka zotësi juridike ose personave që është hequr zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formes së prerë. Testamenti i cili nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji. Në rastet kur testamenti është bërë nën ndikimin e dhunës fizike, mashtrimit, kanosjes janë shkaqe relative që sjellin pavlefshmërinë e testamentit.⁵⁵

c. Paditë në lidhje me trashëgiminë

Në Kodin Civil nga neni 348 -359 janë parashikuar paditë në lidhje me trashëgiminë. Nga formulimi i këtyre dispozitave ekzistojnë tre paditë në lidhje me trashëgiminë:

1. Dëshmia e trashëgimisë
2. Padia për kërkimin e trashëgimit
3. Pjestimi i trashëgimit.

Nga mënyra se si Kodi Civil e trajton dëshminë e trashëgimisë shohim se ai e rregullon atë në një dispozitë që të referon në ligjin e Procedurës Civile. Dëshmia e trashëgimit lëshohet vetëm pas vdekjes së personit. Kërkesën mund ta bëjnë familjarët e ngushtë. Gjykimi bëhet pa palë kundërshtuese dhe ka karakter deklarativ.

Në rastin e dytë të kërimit të trashëgimit të pasurisë nga personi që i takon dhe të cilit i është mohuar e drejta e trashëgimitarit, ai ka të drejtë të bëjë padi për njohjen e tij si trashëgimtar. Për

⁵⁵ A. Nuni, L. Hasneziri, Edrejta e Civile III (trashëgimia), Tirane, 2010, fq. 161

këtë duhet plotësuar dy kushte: të provoj se është trashëgimtar i personit d.m.th të provoj legjitimitimin aktiv dhe të ngre padinë kundër personit të cilit i mohojnë cilësinë e trashëgimtarit.

Te padia e tretë në lidhje me pjestimin e trashëgimiti Kodi Civil e njeh të drejtën e trashëgimtarit që në cdo kohë të kërkojë pjestimin e pasurisë⁵⁶Kjo padi mund të ngrihet në cdo kohë nga secili trashëgimtar dhe nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit dhe kanë karakter urdhëruar që do të thotë përmbajnë një të drejtë absolute të trashëgimtarëve. Pjestimi i pasurisë mes trashëgimtarëve bëhet ose me marrëveshje të tyre ose me vendim gjyqësor të parashikuar në neni (354 Kodi Civil)⁵⁷

Konkluzioni

Në kapitujt e lartëshënuar trajtuam historikun e trashëgimisë që nga e drejta romake gjer më sot. Ato shfaqin një përafërsi dhe njëanshmëri të dukshme me ca veti të pakta dallimi.Gjithashtu kemi trajtuar rregullimin ligjor të institutit të trashëgimisë sipas legjislacionit në fuqi.

Gjatë jetës personi është i lirë ta tjetërtoj pasurinë e tij ndaj cilido personi që dëshiron.

Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm që realizohet dhe mer fuqi të plotë vetëm në formën e caktuar nga ligji. Egzistenca e tij prezumohet vetëm nëse paraqitet i shkruar prej testatorit ose prej personit të autorizuar nga ligji. Ai është një akt unipersonal se realizohet personalisht nga testatori dhe është i padelegueshëm. Ai është një veprim i njëanshëm me kusht ku është pikërisht shkaku i vdekjes që e përcakton kushtin.

Edhe pse në Kosovë egziston ligji i trashëgimisë që u mundëson qytetarëve ta gëzojnë trashëgiminë e pasurisë familjare ky ligj në praktikë nuk zbatohet plotësisht posaqërisht kur janë në pyetje femrat. Kjo është traditë më tepër në vendet rurale si pasojë e traditave të vjetra shqiptare edhe pse e drejta e trashëgimisë ju takon të gjithë anëtarëve të familjës pa marrë parasysh gjininë.Edhe pse të barabarët para ligjit si rezultat i mentalitetit tradicional shumë gra në Kosovë nuk trashëgojnë pronën që ju takon duke ua lënë mundësinë që këtë ta gëzojnë anëtarët e tjerë të familjës.

⁵⁶ Neni 353 i Kodit Civil

⁵⁷ Po aty neni 354

Nga ana tjetër konfliktet gjyqësore po bëhen gjithnjë e më shumë pjesë e pa ndarë dhe e rëndësishme e punës së gjyqëtarëve dhe avokatëve, cka tregon edhe për vlerën gjithnjë më të madhe që po merr ky institut i të drejtës në praktikën gjyqësore.

Të gjitha këto tregojnë se ky institut dhe marja e njohurive në këtë fushë është një nga kërkesat më themelore për formimin e juristave të ardhshëm.

Për të qenë e mundshme që të gjithë të jenë të barabartë në trashëgimi Insitucionet shtetërore duhet të respektojnë në maksimum ligjet egzistuese dhe të ndërmarrin hapat e duhur në parandalimin dhe zhdukjen e malverzimeve nga personat e pa ndërgjegjshëm, gjithashtu ti zbatojnë ligjet me paanshëmëri dhe përgjegjësi maksimale.

Literatura

1. Dr.Sc.Hamndi Podvorica,E Drejta Trashëgimore,Prishtinë 2010
2. Ardian Nuni,Luan Hasneziri,E Drejta Civile III(trashëgimia),Tiranë,2010
3. Gams,Andrija, Hyrje në të Drejtën Civile,Prishtinë,1988
4. Nazmi Bicoku,Të Drejtat e Trashëgimisë të R.Shqipërisë,Tiranë,1997
5. Tawil, Edward, Të Drejtat e Pronësisë në Kosovë, Një trashëgimi e shoqërisë në tranzicion,shkurt,2009
6. E Drejta Romake,ligjerata të autorizuara,Prof.Dr.Berat Aqifi
7. Prof.Dr.Abdulla Aliu,E Drejta Civile ,Prishtinë,2013

Aktet Ligjore

1. Kushtetuta e R.Kosovës
2. Kushtetuta e R.Shqipërisë
3. Ligji për Trashëgiminë e Kosovës,Nr.2004/26(LTK)
4. Kodi Civil i Shqipërisë i vitit 1929
5. Kodi Civil i Shqipërisë në fuqi, i vitit 1994
6. Kanuni i Lekë Dukagjinit,Rilindja,Prishtinë,1995
7. Kodi i Familjës i R. Shqipërisë
8. Ligji për Barazi Gjinore,Nr.2004/2
9. Ligji për Procedurën Jokontestimore,Nr.03/L-007